



REPUBLIKA E KOSOVËS / REPUBLIKA KOSOVA

GJYKATA THEMELORE PRISHTINE

Numri i lëndës: 2019:220707

Datë: 31.07.2021

Numri i dokumentit: 02050470

**P.nr.1005/18**

### **NË EMËR TË POPULLIT**

**GJYKATA THEMELORE NE PRISHTINË - Departamenti i Përgjithshëm – Divizioni Penal**, me gjyqtarin e vetëm gjykues Adnan Kamberi, në çështjen penale kundër të pandehurit H. J., për shkak të veprës penale lëndim i lehtë trupor nga neni 188 par.3, nënpar. 3.1 të Kodit Penal të Republikës së Kosovës (KPRK), i akuzuar sipas aktakuzës së Prokurorisë Themelore Prishtinë – Departamentit të Përgjithshëm, me numër PP.II.nr. 3091/2016, të datës 26.02.2018, pas mbajtjes dhe përfundimit të seancës së shqyrtimit fillestar, verbal dhe jopublik me datë 29.07.2021, në prani të Prokurorit të Shtetit Fatmire Cacaj dhe të pandehurit H. J., më datë 30.07.2021 mori dhe publikisht shpalli, dhe të njëjtën ditë përpiloi këtë:

### **A K T G J Y K I M**

#### **Kundër të pandehurit:**

**H. J.**, nga I ati A. dhe nëna H., e vajzërisë D., I lindur më datë ..., në fshatin O. Komuna Podujevë, me vendbanim në rr. “...” nr., në Prishtinë, ka të kryer shkollën e mesme, me profesion vozitës, I martuar, I gjendjes së mesme ekonomike, me nr. personal ..., shqiptar, shtetas i Republikës së Kosovës.

### **ËSHTË FAJTOR**

#### **Sepse:**

Me datë 03.05.2016, rreth orës 23.30 min, në Prishtinë, në Rr. “...” përkatësisht në shtëpinë e tyre të përbashkët, për shkak të mosmarrëveshjes së atëçastshme lidhur me vizitën mjekësore të vajzës së tyre dy javësh, me dashje, me qëllim të shkaktimit të dëmtimit trupor, ka sulmuar fizikisht të dëmtuarën E. C. (bashkëshorten) në atë mënyrë që, fillimisht e ka fyer me fjalë e pastaj me boksa dore si dhe me shkelma e ka goditur në pjesë të ndryshme të trupit, me ç ‘rast, e dëmtuara sipas ekspertizës mjeko ligjore ka pësuar dëmtime të lehta trupore me pasoja të përkohshme për shëndetin-,

- **Me këtë ka kryer veprën penale lëndim i lehtë trupor nga neni 188 par.3, nënpar. 3.1 të Kodit Penal të Republikës së Kosovës (KPRK).**

Andaj, gjykata konform neneve 1, 2, 4, 7, 8, 9, 10, 41, 42, 49, 50, 51, 52, 73, 74, të KPRK-së, si dhe neneve 248, 365, 453, 463, të KPP-së, të pandehurin:

### **E GJYKON**

**1. Me dënim me burgim, në kohëzgjatje prej gjashtë (6) muaj,** i cili dënim nuk do të ekzekutohet nëse i pandehuri brenda periudhës së verifikimit në kohëzgjatje prej një (1) viti nuk kryen veprën tjetër penale.

**2. Obligohet i pandehuri që të i paguaj shpenzimet e procedurës penale në emër të paushallit fillestar shumë prej 30 euro, në emër të ekspertizës mjeko ligjore shumë prej 20 euro, kurse në emër të Fondit për Mbrojtjen e Viktimave të paguajë shumë prej 30€, të gjitha këto në afat prej 15 ditësh nga dita e plotfuqishmërisë së këtij aktgjykimi.**

**3. Pala e dëmtuar për realizimin e kërkesës pasurore juridike udhëzohet në kontest civil.**

### **A r s y e t i m**

Prokuroria Themelore në Prishtinë – Departamenti i Përgjithshëm ka paraqitur aktakuzën me numër PP.II.nr. 3091/2016, të datës 26.02.2018, kundër të pandehurit H. J., për shkak të veprës penale lëndim i lehtë trupor nga neni 188 par.3 nënpar. 3.1 të Kodit Penal të Republikës së Kosovës (KPRK).

Gjykata sipas detyrës zyrtare, pas vlerësimit të kompetencës lëndore dhe territoriale në këtë çështje penale, ka caktuar dhe mbajtur seancën e shqyrtimit fillestar në prezencë të Prokurorit të Shtetit dhe të akuzuarit. Në seancën e shqyrtimit fillestar pas leximit të aktakuzës nga Prokurori i Shtetit, i pandehuri H. J. ka pranuar në tërësi fajësinë për veprën penale Lëndim i lehtë trupor nga neni 188 par.3 nënpar. 3.1 të Kodit Penal të Republikës së Kosovës (KPRK).

Lidhur me pranimin e fajësisë nga ana e të pandehurit, Prokurori i Shtetit në shqyrtim fillestar deklaroi pajtohem me pranimin e fajësisë nga i pandehuri ngase mbështetet në provat materiale dhe personale të cilat gjenden në shkresat e lëndës, po ashtu në këtë seancë në pajtim me nenin 248 të KPP-së, i pandehuri pranon fajësinë, i propozojë gjykatës që të miratojë pranimin e fajësisë, ta shpallë fajtor të pandehurin për veprën penale për të cilën akuzohet dhe pas vlerësimit të të gjitha rrethanave lehtësuese dhe rënduese ti shqiptojë dënim sipas ligjit.

I pandehuri pas pranimin të fajësisë ka deklaruar se pranimin e fajësisë e ka bërë me vullnet dhe vetëdije të plotë, i vetëdijshëm për pasojat dhe benefitet e pranimin të fajësisë, tutje i pandehuri ka deklaruar se ndjenë keqardhje për veprën të cilën e ka kryer, i premtojë gjykatës së nuk do të përsërisë me vepra penale, i kam kërkuar faje palës së dëmtuar për veprën të cilën e kam kryer, dhe i ka propozuar gjykatës që pranimin e fajësisë dhe rrethanat tjera ti merr si rrethana lehtësuese.

Gjykata ka shqyrtuar pranimin e fajësisë për të pandehurin H. J. në mbështetje të nenit 248 të KPPRK, dhe në këtë drejtim vlerëson se janë përmbushur kushtet ligjore për pranimin e fajësisë për të pandehurin.

Gjykata ka vërtetuar se pranimi i fajësisë nga ana e të akuzuarit H. J. mbështetet në provat me të cilat disponon kjo gjykatë. Gjykata konstaton se në bazë të provave të cilat gjenden në shkresat e lëndës vërtetohet përtej çdo dyshimi të bazuar mirë se i pandehuri ka kryer veprën penale Lëndim i lehtë trupor nga neni 188 par.3 nënpar. 3.1 të Kodit Penal të Republikës së Kosovës (KPRK), për të cilën i pandehuri edhe u shpall fajtor nga kjo gjykatë. Dyshimi i bazuar mirë u vërtetua edhe në bazë të: aktvendimi për fillimin e hetimeve dt. 01.12.2017, ekspertizës mjeko – ligjore të Dr. V. K. të datës 17.12.2017, kallëzimi penal dt. 07.06.2016, raporti fillestar i incidentit dt. 03.05.2016, procesverbal mbi intervistimin e

ankuesit dt. 04.05.2016, procesverbal mbi intervizimin e të dyshuarit dt. 04.05.2016, lista e evidencës, raporti i policit dt. 04.05.2016, shënim zyrtar dt. 04.05.2016, raporti i shpejtë dt. 04.05.2016, thirrje për ndihme të shpejtë mjekësore nr. 4186 dt. 04.05.2016, Njësia e Forenzikës – Lista e dëshmimeve dt. 04.05.2016, si dhe nga vetë deklarimi i të akuzuarit ne seancën e shqyrtimit fillestar ne të cilën seancë pranojë në tërësi fajësinë për veprën penale lëndim i lehtë trupor nga neni 188 par. 3 nënpar. 3.1 të Kodit Penal të Republikës së Kosovës (KPRK). Andaj, nga të lartcekurat gjykata konstaton se u vërtetuar përtej çdo dyshimi të bazuar mirë se i pandehuri ka kryer veprën penale e për të cilën u shpallë fajtor nga kjo gjykatë.

Gjykata, gjithashtu ka vërtetuar se me rastin e pranimit të fajësisë i pandehuri e kupton natyrën dhe pasojat e pranimit të fajësisë, se pranimi i fajësisë nga ana e të akuzuarit H. J. është bërë në mënyrë vullnetare, se pranimi i fajësisë mbështetet ne faktet e çështjes që përmban aktakuza, si dhe aktakuza nuk përmban ndonjë shkelje të qartë ligjore apo gabim faktik, nga këto arsye gjykata e ka aprovuar pranimin e fajësisë të bërë nga i pandehuri, sipas nenit 248 të Kodit të Procedurës Penale të Kosovës.

Gjykata, nga pranimi i fajësisë nga i pandehuri H. J. dhe nga provat e cekura si më lartë, ka vërtetuar pa mëdyshje se i pandehuri ka kryer veprën penale për të cilën është akuzuar dhe shpallur fajtor sipas këtij aktgjykimi.

Gjykata, lidhur me caktimin e llojit dhe lartësisë e dënimit nga neni 73 të KPRK, për të pandehurin H. J., për veprën penale lehtë trupor nga neni 188 par.3 nënpar. 3.1 të Kodit Penal të Republikës së Kosovës (KPRK), mori parasysh rrethanat lehtësuese si dhe rrethanat rënduese. Si rrethanë lehtësuese Gjykata vlerësoi: se i pandehuri ka pranuar fajësinë në tërësi për veprat penale për të cilën akuzohet në fillim të seancës së shqyrtimit fillestar, se i pandehuri është i moshës së re dhe i njëjti ka shprehur keqardhje për veprën penale të cilën e ka kryer dhe se i ka premtuar gjykatës se nuk do të përsërisë vepra penale, i ka kërkuar falje palës së dëmtuar për veprën penale të cilën e ka kryer. Ndërkaq, si rrethanë rënduese Gjykata ka vlerësuar se natyra e tillë e veprave penale është mjaft e shpeshtë në Republikën e Kosovës, dhe ndikojnë në prishjen e raporteve familjare dhe shoqërore në përgjithësi, gjithashtu si rrethanë rënduese gjykata pati parasysh edhe natyrën e të mirës juridike të mbrojtur me të drejtën penale si dhe dëmin e shkaktuar me kryerjen e veprës penale, pra cenimin e integritetit truporë të palës së dëmtuar në këtë rast.

Gjykata, duke pasur parasysh rrethanat lehtësuese dhe rrethanat rënduese, si dhe duke pasur parasysh se veprat penale për të cilën akuzohet i pandehuri nga Prokurori i Shtetit, si dhe fakti se i pandehuri e ka pranuar ne tërësi fajësinë për veprën penale për të cilin akuzohet dhe është shpallur fajtor sipas këtij aktgjykimi, gjykata i ka caktuar për veprën penale lëndim i lehtë trupor nga neni 188 par.3 nënpar. 3.1 të Kodit Penal të Republikës së Kosovës (KPRK), dënim me burgim, në kohëzgjatje prej gjashtë (6) muaj,i cili dënim nuk do të ekzekutohet nëse i pandehuri brenda periudhës së verifikimit në kohëzgjatje prej një (1) viti nuk kryen vepër tjetër penale. Duke e arsyetuar se për veprën penale Lëndim i lehtë trupor nga neni 188 par. 3, nënpar. 3.1 të KPRK, parashihet se: *“Kur vepra penale nga ky nen kryhet ndaj viktimës së ndjeshme, kryesi dënohet me: 3.1. burgim prej tre (3) muaj deri në tre (3) vjet për veprën penale nga paragrafi 1”*. Andaj, mbështetur ne rrethanat lehtësuese dhe rrethanat rënduese, politikën ndëshkimore si dhe duke pasur parasysh minimumin dhe maksimumin e dënimit të paraparë për veprën penale të cilën e ka kryer i pandehuri, Gjykata të pandehurin e gjykoj si në dispozitiv të këtij aktgjykimi.

Në harmoni me këto dispozita ligjore gjykata duke pasur parasysh rrethanat ne të cilat është kryer vepra penale, sjelljet e kryerësit para dhe pas kryerjes së veprës penale, pranimin e

fajësisë nga ana e të akuzuarit, gjykata konstatoi se shqiptimi i dënimit është në harmoni me qëllimin e dënimit dhe se do ta arrij qëllimin e dënimit të paraparë me nenin 41 par. 1 dhe atë: të parandalojë kryesin nga kryerja e veprave penale në të ardhmen dhe të bëjë rehabilitimin e ti, të parandalojë personat e tjerë nga kryerja e veprave penale, të shprehë gjykimin shoqëror për veprën penale, ngritjen e moralit dhe forcimin e detyrimit për respektimin e ligjit.

Pala e dëmtuar për realizimin e kërkesës pasurore juridike udhëzohet në kontest civil.

Lidhur me shpenzimet e procedurës penale, gjykata ka vendosur në përputhje me nenin 450, 453 të KPP-së, ndërsa vendimi për kompensimin e viktimave të krimit u mor në bazë të Ligjit nr.05/L-036.

Nga ajo çfarë u tha me lart, në bazë të neneve 188 par. 3, nënpar. 3.1, të KPRK-së, dhe 248, 365, 450, 453, 463 të KPP-së, u vendos si në dispozitivin e këtij aktgjykimi

**GJYKATA THEMELORE NË PRISHTINË**  
**Departamenti i Përgjithshëm-Divizioni Penal**  
**P.nr. 1005/18; datë 30.07.2021**

**G j y q t a r i**  
**Adnan Kamberi**

**KËSHILLA JURIDIKE:**

Kundër këtij aktgjykimi, është e lejuar e drejta e ankesës në afatin prej 15 ditësh, nga dita e pranimit të aktgjykimit. Ankesa i drejtohet gjykatës së Apelit në Prishtinë, nëpërmjet kësaj gjykate në kopje të mjaftueshme për gjykatën.